

Njoftim i përqendrimit me të cilin Aramko Oversiis Kompani B.V. Holandë dhe EIG Manaxhment Kompani LLC, SHBA, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi MidOushn Holdings II L.P. Mbretëria e Bashkuar

(lënda nr. 08-151/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 16.10.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin "Aramko Ovrsiis Kompani B.V." (Aramco Overseas Company B.V.), me seli të regjistruar në Sheveningseveg 64 2517 KH Hag, Holandë dhe EIG Manaxhment Kompani LLC, SHBA (EIG Management Company, LLC), me seli kryesore në 600 Nju Hempshajr Avenju NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi MidOushn Holdings II L.P. (MidOcean Holdings II L.P.), një partneritet i kufizuar me zyrën e tij të regjistruar në 50 Lotian Roud, Festival Skver, Edinburg, EH3 9WJ, Mbretëria e Bashkuar, ("MidOushn Holdings II") dhe indirekt mbi MidOushn Enerxhi LLC (MidOcean Energy LLC), me zyrën e saj kryesore në 600 Nju Hempshajr Avenue NW, Suit 1200, Uashington, DC 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ("Sipërmarrja e përbashkët e propozuar").

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :

Aramko Ovrsiis Kompani B.V.(Aramco Overseas Company B.V.) është një shoqëri e varur indirekte tërësisht në pronësi të Saudi Arabijan Oil Kompani(Saudi Arabian Oil Company), me seli kryesore në kutinë postare 5000, Dahrn, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite (**Saudi Aramko**). **Saudi Aramko** është një shoqëri aksionare e themeluar nga Dekreti Mbretëror nr. M / 8 i Arabisë Saudite. Saudi Aramko është angazhuar kryesisht në kërkime gjeologjike të prospektit, hulumtime, prishje dhe nxjerrje të substancave hidrokarbure dhe përpunim, prodhim, rafinim dhe vendosje në tregun e këtyre substancave.

Saudi Aramko nuk ka shoqëri të regjistruara të varura në Maqedoninë e Veriut, por kryesisht është e angazhuar në Maqedoninë e Veriut në shitjen e polimerit.

EIG Manaxhment Kompani LLC-(së bashku me fondet e tij të kontrolluara dhe kompanitë përkatëse – EIG), është një investitor kryesor institucional në sektorët globalë të energjisë dhe infrastrukturës, ajo është e specializuar në investime private në energji dhe infrastrukturë në lidhje me energjinë globalisht.

EIG Manaxhment Kompani LLC dhe shoqëritë e lidhura me të ((përfshirë subjektet nën kontrollin e fondeve të kontrolluara nga EIG) nuk kanë aktivitete investimesh ose biznesi në Maqedoninë e Veriut.

Ndërmarrja e përbashkët e propozuar është një shoqëri e gazit natyror të lëngshëm (GNL) e themeluar dhe menaxhuar nga EIG për të zhvilluar një portofol të larmishëm dhe të qëndrueshëm të GNL-së, e cila është gjithashtu konkurrese për sa i përket kostove dhe emetimeve të karbonit. Ndërmarrja e përbashkët e propozuar do të ketë aktivitete të orientuara nga tregu, duke blerë dhe shitur një pjesë të projekteve të palëve të treta të GNL-së në të cilat ka investuar, fillimisht në Australi dhe potencialisht në një vend tjetër në një fazë të mëvonshme. Në Maqedoninë e Veriut, ndërmarrja e përbashkët e propozuar nuk ka pasur asnjë aktivitet deri më tani.

Parashtruesit e njoftimit deklarojnë se tregu relevant i mallrave për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përkufizohet si tregu i eksplorimit të gazit natyror, dhe tregu rritës për furnizimin e gazit natyror me shumicë, ndërsa tregu relevant gjeografik mund të përkufizohet të paktën në nivelin e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe pse tregjet janë në mbarë botën.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

25.10.2023

Shkup